




KOMUNA VUSHTRRI



MITROVICA
KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI PËR FINANCIM TË PËRBASHKËT

Palët Nënshkruese:

1. Komuna e Vushtrrisë, e përfaqësuar nga z. **Xhafer Tahiri**, Kryetar i Komunës dhe
2. Kompania Rajonale e Ujësjiellësit “Mitrovica sh.a.” në Mitrovicë, përfaqësuar nga z. **Sami Miftari**, Kryeshef Ekzekutiv,

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i lidhjes së kësaj marrëveshje është financimi i përbashkët i punëve që do të kryhen nga operatori ekonomik në vendosjen e gypit metalik, $d=700\text{ mm.}$, në gjatësi prej $L=100\text{ m.}$, në thellësi mesatare të gërmimit $h=2.5\text{ m.}$, ventilin kryesor si dhe ndërtimin e pusëtës së betonit $a \times a \times h=5 \times 5 \times 3\text{ m.}$, $d=700\text{ mm.}$; dhe lëshuesin e mbeturinave në shtratin e lumit “Terstena”. në rrugën “Rrustem Hyseni Historiani – “Tahir Sinani” në Vushtri .

Neni 2 Vlera e investimit

2.1 Komuna e Vushtrrisë dhe KRU “Ujësjiellësi” në Mitrovicë dakordohen që të financojnë nga buxhetet e tyre – kryerjen e punimeve të cekur si në nenin paraprak, në vlerë të përgjithshme prej 33,037.50 € (tridhjetetremijë e tridhjeteshtatë euro e pesëdhjetë cent), prej të cilave Komuna e Vushtrrisë dhe KRU “Ujësjiellësi” në Mitrovicë, participojnë secila me 50 % të mjeteve ose me nga 16,518.75 € (gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqindetëmbëdhjetë euro e shtatëdhjetepesë cent).

Neni 3

Obligimet e Kompania Rajonale e Ujësjetlësit “Mitrovica sh.a.” në Mitrovicë

- 3.1 Kompania Rajonale e Ujësjetlësit “Mitrovica sh.a.” në Mitrovicë, cakton organin mbikëqyrës i cili do të jetë pjesë e grupit menaxhues për realizimin e këtij projekti si dhe për inspektimin final të punimeve/pranimin teknik.
- 3.2 . Kompania Rajonale e Ujësjetlësit “Mitrovica sh.a.” në Mitrovicë sipas nevojës do të informoj qytetarët për ndërprerjen e ujit për kohë të caktuar gjatë ekzekutimit të punimeve.
- 3.3 Kompania Rajonale e Ujësjetlësit “Mitrovica sh.a.” në Mitrovicë, me përfundimin e punimeve merr për obligim që të i kryej pagesën e mjeteve në vlerën e cekur në këtë marrëveshje.

Neni 4

Obligimet e Komunës

- 4.1 Komuna e Vushtrrisë do të i kryej punimet në terren me operatorin ekonomik të kontraktuar paraprakisht për kyçe në rrjetin e ujësjetlësit.
- 4.2 Në kuadër të kontratës për kyçe në ujësjetlës komuna ka të caktuar organin mbikëqyrës dhe menaxherin e kontratës.
- 4.3 Komuna e Vushtrrisë pas përfundimit të punimeve në bashkëpunim me KRU “Ujësjetlësi” në Mitrovicë do të bëj raportin e punëve të kryera dhe pranimin teknik
- 4.4 Komuna e Vushtrrisë, me përfundimin e punimeve merr për obligim që të i kryej pagesën e mjeteve në vlerën e cekur në këtë marrëveshje.

Neni 5

Realizimi i marrëveshjes

Palët e kësaj marrëveshje marrin për obligim që punët në teren të kryhen bazuar në paramasën dhe paralogarinë e përgatitur nga inxhinieri Nexhat Merovci, Menaxher i zyrës së projekteve në Komunën e Vushtrrisë si dhe në bazë të përshkrimit teknik.

Neni 6

Ndryshimet e marrëveshjes së mirëkuptimit

Me pëlqimin paraprak të Kryeshefit Ekzekutiv të Kompanisë Rajonale e Ujësjetlësit “Mitrovica sh.a.” në Mitrovicë dhe Kryetarit të Komunës, kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit mund të ndryshohet dhe plotësohet.

Neni 7
Zgjidhja e mosmarrëveshjes

Palët pajtohen që mosmarrëveshjet eventuale të i zgjidhin me mirëkuptim.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit nga palët e marrëveshjes.

Neni 9
Numri i ekzemplarëve

Marrëveshja e mirëkuptimit është përpiluar dhe nënshkruar në katër ekzemplarë në origjinal, nga dy për secilën palë nënshkruese.

KRU "Mitrovica sh.a."

Sami Miftari, Kryeshef Ekzekutiv

